



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

ASMABLEJA E PËRGJITHËSHME E SHOQËRISË
UJËSJELLËS - KANALIZIME MALLAKASTËR

Nr. 1802 prot

Ballsh , më 13/04/2023

VENDIM

NR. 6 DATË 13/04/2023

Sot , më datë 13 Prill 2023 , Asambleja e Shoqërisë Ujësjiellës - Kanalizime Mallakastër , një shoqëri e themeluar sipas ligjit Shqiptar , me kodin unik NIPT :K47605804N , mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë z. Guri Nuhaj , për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës :

- Prishja e shoqërisë dhe shpalljen e saj në likuidim
- Emërimi i likuidatorit

Në shqyrtim të rendit të ditës , Asambleja vëren:

Shoqëria **Ujësjiellës - Kanalizime Mallakastër** nuk zhvillon më aktivitet pasi në përputhje me VKM Nr.302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr.1361 Rep. Dhe Nr.619 Kol , datë 07.10.2022 midis shoqërisë Ujësjiellës - Kanalizime Mallakastër dhe Shoqërisë **“Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier”**sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitet dhe detyrimet e saj në tërësi . Nga data 01.01.2023 , kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër , shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijoj ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të çrregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës , Asambleja vendosi:

- 1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- 2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese
- 3) Emërimin e **z. Egerem BEQIRAJ** si likuidator të shoqërisë.
- 4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë raportin Përfundimtarë të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjistacionin e aplikueshem për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë , paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u siguria se nuk ka më çështje për diskutim , mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETARI

Qerim ISMAILAJ

